



MANUALI I ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE NË SHKOLLA

Bëhu pjesë e zgjidhjes!
“NDËRMJETËSIT E RINJ”



KONFLIKTI EKZISTON KUR NJË PERSON KA NJË APO DISA NEVOJA DHE KËTO NEVOJA NUK PLOTËSOHEN.

KONFLIKT KEMI:



Kur komunikimi nuk është i hapur, jo i sinqertë apo i pamjaftueshëm dhe çorientues në mënyrë të qëllimshme dhe nisin të shfaqen kërcënimet dhe presioni.

Kur ajo që ndan shihet më qartë se ajo që bashkon dhe kur gjestet pajtuese të tjetrit interpretohen si përpjekje për mashtrim dhe kërkesat e tij gjykohen si armiqësore.



Kur ulet besimi dhe rritet mosbesimi, ulet gatishmëria për të mbështetur tjetrin me këshilla dhe veprime dhe rritet gatishmëria për të shfrytëzuar, demaskuar dhe poshtëruar tjetrin.

Paragjykimet dhe mungesa e tolerancës që nxënësit kanë për racën, fenë, gjininë, orientimin seksual, pamjen e jashtme, sjelljen, gjuhën e trupit, personalitetin, karakteristikat fizike ose aftësinë mendore.

Gjuha e urrejtjes në komentimin e çështjeve të ndryshme në media ose rrjetet sociale shpesh shndërrohet në motiv konflikti. Diskutimi degradon në konflikt për bindje fanatike të personit që nuk pranon kundërshti nga ata që kanë një mendim ndryshe.



PASOJAT E KONFLIKTIT

Pengesa në procesin e mësimdhënies. Konfliktet krijojnë një mjedis të mbushur me negativitet dhe tension ku nuk mund të punohet në mënyrë produktive për detyrat në klasë apo punët në grupe. Nxënësit që gjenerojnë konfliktin mund të krijojnë probleme të besimit mes bashkëmoshatarëve të tyre.




Shfaqja e bullizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Shpesh herë është pasojë e mosmarrëveshjes apo keqmenaxhimit të konfliktit të pazgjidhur.



Zgjidhjet e konflikteve janë gjithmonë të nevojshme sepse:

1. Ndhimjnë të ngrihen dhe adresohen probleme.
2. Ndhimjnë që puna në grup të bëhet më mirë.
3. Ndhimjnë njerëzit që të jenë “realë” dhe të marrin pjesë në veprimtari.
4. Ndhimjnë njerëzit të përfitojnë nga diferencat ndërmjet tyre.

MENAXHIMI I KONFLIKTIT NË SHKOLLA



Nëse konflikti juaj ka kapërcyer në fazën kur bëhet e **vështirë për t'u menaxhuar**, atëherë duhet të mendoni seriozisht për të **përfshirë një palë të tretë për t'ju ndihmuar me ndërmjetësimin** gjatë grindjes apo konfliktit.

ÇFARË DUHET TË KETË PARASYSH NJË NDËRMJETËS

Individi vepron si ndërmjetës neutral që ndihmon palët në konflikt të **kuptojnë shkaqet rrënjësore të mosmarrëveshjes** së tyre dhe në fund të bien dakort për një plan për zgjidhjen e konfliktit duke ndjekur këto hapa:



1

Pranohu nga të dyja palët si ndërmjetës



2

Fokusohuni tek interesat dhe problemet



3

Krijohu zgjidhje win-win



4

Vlerësoni të gjitha opsionet e zgjidhjes



5

Krijoni një marrëveshje



KONFLIKT MES SHOKËVE!! ATËHERË:

- ✓ Dëgjojini me kujdes dhe mos u bëni palë me asnjë anë
 - ✓ Inkurajoni shokët të flasin
- ✓ Ndhmoni shokët tuaj të eksplorojnë rrënjët e konfliktit
 - ✓ Pyeti se si mund ti ndihmosh
 - ✓ Ndhmoi të sqarojnë secili situatën e tij
 - ✓ Mos impononi normat tuaja kulturore gjatë ofrimit të zgjidhjes
- ✓ Ndhmoni pjesëmarrësit në konflikt të përqëndrohen në probleme jo në njerëz.
- ✓ Mos ofroni zgjidhje, ofroni hapësirën që pjesëmarrësit ta arrijnë vetë zgjidhjen.
- ✓ Nxiteni shokun tuaj të formulojë zgjidhje të mundshme për problemin. Në këtë mënyrë ai do të ndihet më i përfshirë në fazën e zgjidhjes dhe do të mbështesë propozimet e tij.

KËSHILLA MBI ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE



Konflikti është një realitet. Shmangia nuk do të ndryshojë asgjë.

Mësoni të merreni me problemin jo me personin. Konflikti ndodh për shkak të një çështjeje jo për shkak të një personi.



Respekto dhe dëgjo me vëmendje të dyja palët

Mëso të negociosh. Kjo është aftësia më e rëndësishme që ju duhet të mësoni.



Ji i sigurt. Ju nuk duhet të jeni as pasiv as agresiv për të trajtuar konfliktet midis shokëve tuaj. Duhet të jeni i sigurt duke vendosur pikëpamjet e tua përpara me besim dhe qetësi.

Betimi i Ndërmjetësve të rinj!

Ne Ndërmjetësit e Rinj, zotohemi se:

Do të ndërmjetësojmë në çdo rast
konflikti midis shokëve tanë në shkollë.

Do të ndihmojmë bashkëmoshatarët tanë të
zgjidhin konfliktet mes tyre.

Do të jemi të paanshëm dhe nuk do të
favorizojmë idetë e njëjës palë.

Do të parandalojmë dhunën për shkak të
konflikteve mes shokëve në klasën tonë.

Do të jemi mesazhierë të tolerancës dhe paqes
në mjedisin shkollor.

Do ta ruajmë mirënjohjen dhe respektin e duhur
ndaj shokëve dhe mësuesve.



Qëndresa Qytetare ka për qëllim ti prezantojë nxënësit me programe të ndërmjetësimit ndaj bashkëmoshatarëve në shkolla, bazuar në një model edukimi që fuqizon individët për të parandaluar, zgjidhur dhe transformuar konflikte të dhunshme dhe jo të dhunshme duke zhvilluar vlerat, aftësitë dhe njohuritë për të parashikuar mundësi alternative për të vepruar drejt ndërtimit të paqes.

Nxënësit e shkollave duhet të marrin role drejtuese në shkollë për të promovuar një klimë respekti dhe tolerance duke ndihmuar bashkëmoshatarët e tyre për të zgjidhur konfliktet në mjediset shkollore në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe zhvillimit të rregullave dhe të politikave kundër bullizmit në shkollë.

Ky manual është përgatitur nga Qëndresa Qytetare për trajtimin dhe ndërmjetësimin e konflikteve midis nxënësve në shkolla dhe është mbështetur nga Programi "Fuqizimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" i Ambasadës Suedeze.



**QËNDRESA
QYTETARE**



PROGRAM



**Suedi
Sverige**